## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** AKAID II, *Parimet e besimit.*

**Programi i studimit:** Teologji Islame

**Numri i ECTS kredive:** 6

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 201

**Fondi i orëve:** 2+2

**Viti akademik:** 2026/2027

**Semestri:** III

**Mësimdhënësi:** Dr. Bahri Hoxha. Kontakti: e-maili: bhoxha9@live.com

## Përshkrimi i shkurtër i lëndës

Kjo lëndë ngërthen studimin e kushteve te besimit; besimin në Zotin Një, në melekët, në Librat e Tij, në të dërguarit e Tij, besimin në Ditën e Kiametit, dhe jetën e pastajme. Shenjat e vogla dhe shenjat e mëdha të kësaj Dite. Fillimi i llogaridhënies, Xheneti dhe Xhehemi. Doktrinat mbi konceptin e Imanit tek Ehli Suneti. Çështja e akuzimit me herezi. Emrat e bukur të Allahut xh.sh.

## Qëllimi i lëndës

Njohja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Akaidit\Besimit Islam, parimet themelore siç është besimin në Zotin Një, në librat hyjnorë, në melekë, të dërguar dhe në jetën e pastajme. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e ndryshme mbi besimin të cilat përfshin programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse në tekstet themelore të besimit islam. Aftësimi për të shkruar ese, apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Akadi II, presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë njohuri të detajuar mbi tema të rëndësishme të besimit islam. Të kuptojë qëndrimet rreth besimit në ringjallje dhe mënyrën e saj. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, t'i kuptojë çështjet ndaj të cilave pati debate të shumta, që edhe ky të kontribuojë në këto pikëpamje. Të kuptojë se zhvillimi i studimit të besimit është në interes të ngritjes së individit dhe shoqërisë në aspektin moral, sepse ia kultivon njeriut humanizmin dhe e bën më të hapur dhe shpirtgjerë në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

## Rezultatet e pritura të nxënies:

**Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:**

Të përshkruaj mënyrën e besimit në Zotin Një, në librat, melekët, dhe jetën e pasme-ahiret.

Të krahasoj ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme ndaj çështjeve të besimit të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutojë rreth çështjeve të besimit islam në bazë të argumenteve esenciale islame, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbrojë qëndrimet e pikëpamjeve të ndryshme rreth ringjalljes ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantojë mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke paraqitur atë më të vlefshmin.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikojë në relacionet shoqërore në vendin tonë

## Metodologjia e mësimdhënies:

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve.

## Përmbajtja e lëndës:

**Java e parë:** Hyrje, njohje me syllabusin, prezantim i përgjithshëm i lëndës dhe metodologjisë së shtjellimit. Prezantim i shkurtër i dhjetë parimeve të shkencës së Akaidit**.**

**Literatura:** Mr. Naim Tërnava, **Besimi Islam –shtyllat veçoritë dhe rëndësia** 2020,. *(Në vazhdim do të maftohemi vetëm me cekjen e faqeve të kësaj reference shkencore).*

**Java e dytë:** Besimi në Allahun xh.sh. Kuptimi i drejtë islam dhe keqkuptimet.

Argumentet që vërtetojnë ekzistimin e Allahut xh.sh. Argumentet e njeshmërisë së Allahut.

Argumenti ontologjik, i qellimit, i kauzalitetit, i harmonisë, i mospajtimit, etj…

***Debat** rreth argumenteve për ekzistimin e Zotit.*

**Literatura:** (f. 37-58).

**Java e tretë:** Pikëpamjet e filozofëve islamë dhe krahasimi me dijetarët e akaidit në argumentimin rreth ekzistimit të Allahut xh.sh. si: Kindiu, Farabiu, Ibn Sina, Ibn Rushd.

***Bisedë** interaktive rreth pozicionit të filozofëve islamë.*

**Literatura**: (f. 62-68).

**Java e katërt:** Besimi në engjëj të Allahut, pozitat dhe numri i tyre, detyrat e engjëjve. Engjëjt kryesorë: Xhibrili, Mikaili, Israfili, meleku i vdekjes.

(Propozim i temave seminarike).

**Literatura**: (f. 85-128).

**Java e pestë:** Besimi në Librat e Shpallur, veçoritë dhe të përbashkëtat e tyre. Relacioni në mes cilësisë së të folurit (El Kelam) dhe Librave të shpallur; Tevrati, Zeburi, Inxhili dhe Kurani. Fletushkat e të dërguarve.

**Literatura**: (f. 131-174).

**Java e gjashtë:** Besimi në Pejgamberët e Allahut xh.sh., konceptet: "Resul", "Nebij". Cilësitë e Pejgamberëve. Pejgamberia e Muhammedit a.s. dhe përmbyllja e saj.

***Bisedë** rreth nevojës së njeriut për misionin pejgamberik.*

**Literatura**: (f. 177-200 dhe 213-261)

**Java e shtatë:** Koncepti i mrekullive të pejgamberëve. Roli i muxhizes në besim, llojet e saj, ndikimi në vërtetësinë e misionit pejgamberik.

***Testi i parë**.....*

**Literatura**: (f.291-314)

**Java e tetë:** Besimi në Ditën e Gjykimit- (Kijametit),Berzahu, Ringjallja dhe argumentet rreth saj. Natyra e ringjalljes (trupi dhe shpirti).

***Bisedë** rreth argumenteve dhe dyshimeve për ringjallje.*

**Literatura**: (f. 334-372, dhe 407-452)**.**

**Java e nëntë**: Dita e Gjykimit dhe ngjarjet e saj, Kroi (Haud), Tubimi (Hashri), Peshorja, Ura (Sirati), Ndërmetësimi (Shefati), etj.

***Bisedë**: Ndikimi i besimit në Ditën e Kijametit në sjelljen e besimtarit.*

**Literatura**: (f. 455-496 dhe 497-510)**.**

**Java e dhjetë:** Kadaja dhe Kaderi. Kuptimi i drejtë dhe i zhdrejtë i Kadasë dhe Kaderit. Devijimet historike. Roli i njeriut dhe pergjegjësia në perzgjedhjen e veprave.

**Literatura** : (f. 513-591)**.**

**Java e njëmbëdhjetë:** Koncepti i realitetit të imanit në mes të fraksioneve islame. Argumentet dhe keqkuptimet.

**Literatura**: Vehbi Gavoçi, **Nyja e besimit sipas Imam Tahaviut** (f.121-127).

**Java e dymbëdhjetë:** Koncepti i mëkatit në fe. Mëkatimi në mes të natyrës njerëzore dhe ndalesës hyjnore. Kategoritë e mëkateve. Pasojat e mëkatit në kuptimin e drejtë islam.

***Bisedë** rreth bashkëveprimit me mëkatin dhe mëkatarin në shoqëritë bashkohore.*

**Literatura**: : Mr. Naim Tërnava, **Besimi Islam –shtyllat veçoritë dhe rëndësia** 2020, (f. 595-630). *(Në vazhdim do të maftohemi vetëm me cekjen e faqeve të kësaj reference shkencore).*

**Java e trembëdhjetë:** Pozicionet e fraksioneve fetare rreth mëkatit të madh në stadin historik. Shfaqja e tekfirit dhe qendrimi i Ehli Sunetit ndaj kësaj dukurie. Keqpërdorimi i argumenteve fetare.

**Literatura**: (f. 630-638)**.**

**Java e katërmbëdhjetë**: Pasojat e devijimeve rreth mëkatarit dhe sfidat e shoqërisë islame në kohën bashkohore.

***Bisedë** rreth sfidave të reja në keqkuptimin e çështjës së akuzimit me kufr - tekfirit.*

**Literatura:**.

**Java e pesëmbëdhjetë**: Emrat e Allahut dhe reflektimi i tyre te besimtari**.**

**Literatura**: (fq. 773-791)**.**

**Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

**Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%**

**Punimi seminarik 20%**

**Testi intermedier 30%**

**Provimi final 40%**

**Total 100%**

**Literatura obliguese:**

1. ***Besimi Islam –shtyllat veçoritë dhe rëndësia*** Mr. Naim Tërnava, Prishtinë**,** 2020
2. , ***Nyja e Besimit sipas Imam Tahaviut***, Vehbi Gavoçi, perkth. N. Ibrahimi, Prishtinë, 2015.

**Literartura shtesë dhe bibliografia:**

1. ***Hyrje në bazat e besimit islam***, Nexhat Ibrahimi, Prishtinë 2020.

2. ***Argumentet lëndore mbi ekzistimin e Allahut,*** M.M. Sharavi,përkth. S.Bajgora.

5. ***Bazat e besimit në islam***, *B.Topaloglu dhe të tjerë* përkth: M. Hoxha, Prishtinë, 2002.

6. ***Zoti dhe mirazhi i ateizmit***, ***Hamza Andreas Tzortzis***, perkth. V.Zeka, Prishtinë, 2021.

7. ***Njëshmëria e Krijuesit, A. Zindani***, perkth. N. Bjrami, Shkup 2000.